



## MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT

në mes:

**UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA" PEJË**

dhe

**ORGANIZATËS JO-QEVERITARE "OBOTI"**

### NENI I DEFINICIONE

1. Universiteti Haxhi Zeka është institucion publik i arsimit të lartë i Republikës së Kosovës, i rregulluar me ligjet, statutin dhe rregulloret e tjera në fuqi (tutje: UHZ).
2. Organizata Jo-Qeveritare "OBOTI" është organizatë jo-qeveritare dhe jo-profitabile, me qëllim zhvillimin e rinisë përmes bashkëpunimeve ndërkombëtare. Kjo organizatë regjistruar me numër 5119434-9 është themeluar sipas Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ në fuqi, për lirinë e asociimit dhe ka statutin dhe rregulloret. OBOTI gjendet me seli në Prishtinë rruga "Bedrush Collaku" 45, (tutje: OBOTI).

### NENI II QËLLIMI

1. Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit (tutje: Memorandumi) është bashkëpunimi në mes Universitetit Haxhi Zeka dhe OJQ OBOTI për implementimin e aktiviteteve të përbashkëta.
2. Përmes këtij Memorandumi rregullohet bashkëpunimi formal ndërmjet UNHZ-së dhe OBOTIT, lidhur me zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta.
3. Kjo marrëveshje e bashkëpunimit përcakton kornizën e përgjithshme të bashkëpunimit ndërmjet Universitetit "Haxhi Zeka" dhe OJQ "OBOTI".

### NENI III FUSHËVEPRIMTARIA

Ky memorandum i bashkëpunimit përfshin aktivitetet e mëposhtme:

1. Pjesëmarrja në projekte të përbashkëta komunale, shtetërore, rajonale dhe ndërkontinentare;
2. Pjesëmarrja dhe bashkëpunimi në sferën e hulumtimeve, studimeve dhe konsultimeve;
3. Organizimi i konferencave, simpoziumeve, seminareve, kurseve dhe trajnimeve të përbashkëta me studentë dhe pjesëmarrës të tjerë;
4. Aktivitete të tjera me interes të përbashkët.

### NENI IV VENDI, PERIUDHA DHE NDRYSHIMET


1. Vendi i implementimit të këtij memorandumi nuk është i përcaktuar në mënyrë eksplikite dhe do të varet nga aktivitetet.
2. Palët zotohen që do të ofrojnë në shfrytëzim hapësirat e tyre për shfrytëzim varësisht nga aktivitetet dhe brenda mundësive teknike e ligjore.
3. Kohëzgjatja e memorandumit të bashkëpunimit nuk është e kufizuar në kohë, por mund të shkëputet në çdo kohë me paralajmërim të paktën 60 ditë më herët nga cilado palë.
4. Çdo ndryshim në pikat e këtij memorandumi duhet të kërkohet me shkrim nga ndonjëra prej palëve të paktën 15 ditë pure më herët.
5. Anekse shtesë për aktivitete specifike mund të përdoren varësisht nevojës.

### NENI IV KOPJET DHE HYRJA NË FUQI

1. Ky Memorandum është nënshkruar nga palët dhe vulosur në katër kopje origjinale, nga dy për secilën palë.
2. Memorandumi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët.

Prof. Dr. Armand Krasniqi

Rektor, UHZ



Drejtor Ekzekutiv, OBOTI

01 Mars 2023

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA MINISTRI I ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGjisë	UNIVERSITETI UNIVERTZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI	
Nr. / Br. / No. <u>439</u>	Nr. ifaq/ Br. str / No. pg <u>2</u>
Data / Datum / Date: <u>01/03/2023</u> Pojë / Peç	